



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

### DREJTORIJA E INSPEKTORATIT

<b>Datë :</b>	<b>05.12.2016</b>
<b>Referencë</b>	<b>11-344/11</b>
<b>Për :</b>	<b>Kryetar i Komunes-z. Imri Ahmeti</b>
<b>Përmes :</b>	<b>Drejtpërsëdrejti</b>
<b>Nga :</b>	<b>Drejtori i Drejtorisë të Inspektoratit - Imer Rrustemi</b>
<b>Lënda :</b>	<b>RAPORTI MUJOR-NENTOR</b>



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI KOMUNAL - LIPJAN  
DREJTORATI I INSPEKTORATIT



Pasqyra tabelare e punës për muajin –NENTOR

Inspektorët	Gjithsej	Inspektime me procesverbal	Pranime teknike	Fletëparaqitje për kundërvajtje	Inspektime për pirjen e duhanit	Vërejtje, njoftime	Vendosje te shiritav zyrtar	Gjoha mandatore	Inspektime të përbashkëta	Mbyllje e lokalit afarist	Sekuestrim i mallit	Pelqim sanitar	Inspektim i auto-taxi	Menaxhim i tregjeve dhe inspektim i biletave	Aktivendime- ndalesa,urdhëresa	Kërkesa, pune me palë	Mbyllje e përkohshme elokalit afarist	Inspektim i kafshëve në thertore	Inspektime me polici	Inspektim të tokave bujqësore	Mall me afat të skaduar	Biznese te paregjistrume,pa pranime teknike,per çmime
Biznesit	607	45		19		83			71	2	225.39€			8	138	165			3		1018.20€	73
Ambientit	271	37						1	120							106			7			
Bujqësisë	186	14				31			53							58				30		
Ndërtimtarisë	226	37		3			3		149						3	31						
Trafikut	581	62		3		114			69			143	10			89			91			
Sanitar	326	39		4	105	45			68			3				25		37				
<b>Gjithsejtë</b>	<b>2197</b>	<b>234</b>		<b>29</b>	<b>105</b>	<b>2733</b>		<b>1</b>	<b>530</b>	<b>2</b>	<b>225.39€</b>	<b>3</b>	<b>143</b>	<b>18</b>	<b>141</b>	<b>474</b>		<b>37</b>	<b>101</b>	<b>30</b>	<b>1018.20€</b>	<b>73</b>

## DREJTORATI I INSPEKTORIATIT

Gjatë muajit Nëntor kemi punuar intensivisht rreth identifikimit të bizneseve të pa regjistruara MTI, dhe pa pranime teknike të lokaleve afariste për plotësimin e kushteve tekniko higjeno sanitare, kemi kontrolluar maketet ushqimore dhe bizneset e tjera nëpër qytet dhe fshatra, lëmi i kontrollit ka qenë, rreth aftashmërisë së mallit, kushtet e ruajtjes së mallit, faturat e furnizimit me mall dhënien e faturave për shërbimet e ofruara konsumatorëve, çmimet e vendosura në artikuj. Është ndaluar një person nga ana e Polices në Lipjan ku kishte mallë elektro shtëpiak dhe nuk kishte faturë të furnizimit për at mall ku jemi njoftuar nga Policia për këtë rast dhe kemi konstatuar se personi në fjalë ushtron tregti me shumicë dhe atë mall e tregtonte në Serbi ku nuk ishte i regjistruar në ARBK për këtë veprimtari, malli është sekuestruar përkohësisht deri në verifikimin e prejardhjes, ku është verifikuar ai mall në vlerë prej 225.39 € është blerë në tregun e madhë në Fushë Kosovë, ku malli ishte kthyer pronarit në pronësi, ndërsa është iniciuar procedura kundërvajtës në Gjykatën Themelore në Lipjan për mos regjistrim të biznesit.

Gjithashtu në një depo kemi hasur në mall me afat të skaduar në vlerë prej 1018.20 € ku është asgjësuar në vend.

Është bërë një inspektim i përbashkët me inspektorët e AUV-it ku kemi inspektuar stacionet e pompimit të ujit në Lipjan në të cilin inspektorët sanitar nuk kanë gjetur parregullsi higjeno-sanitare.

Gjatë këtij muaji është zhvilluar një aksion i përbashkët me Policin e Kosovën konkretisht me njësitin e Krimeve Ekonomike dhe Trafikimin me qenje njerëzore ku janë inspektuar restaurantet që organizojnë muzikë live, aksioni është zhvilluar pas orë 21 e deri në orët e vona pas mesnatës.

Në thertoren e Komunës sonë gjatë këtij muaji janë therur 37 dema të cilët janë ther në prezencën e mjekut Veterinar.

Gjatë këtij muaji është inspektuar neper disa fshatra si ne Krojmir, Sllovi, Vershevc, Grackë e Vjetër, Ribar i Vogël etj. Inspektimet ishin në lidhje me plehrat e kafshëve, mbeturinat, vërshimin e tokave private nga ujerat atmosferike, kyçjen ne rrjetin e kanalizimit etj. Me ç'rast janë dhënë vërejtje dhe urdhëresa për mënjanimin e parregullsive të gjetura.

Gjatë këtij muaji inspektorati është pais me blloka për gjoba mandatore të cilët janë urdhëruar nga MMPH për ndëshkimin e qytetarëve të pa ndërgjegjshëm të cilët hedhin mbeturina vend e pa vend. Një kordinim të punëve e kemi bërë dhe do ta bëjmë ne vazhdimësi me Policin e Kosovës të cilët do ti kenë bllokat e njëjtë dhe kështu do të vazhdojmë së bashku për parandalimin e hedhjes së mbeturinave në vazhdimësi deri sa të arrihet një kulturë e qytetëruar e njerëzve. Ky organizim do të bëhet me të vetmin qëllim me ruajtjen e mjedisit (ambientit). Një aksion i tillë do të kaloj nga qyteti edhe në fshatra.

Është bërë një gjobë mandatore për një qytetar ne lidhje me ndezjen e mbeturinave plastike. Janë inspektuar hapësirat publike ne lidhje me vendosjen e lendeve djegëse ne këto pjese dhe është inspektuar ne bashkëpunim me inspektore te tjerë dhe me polici.

Gjatë muajit Nëntor është bërë inspektim i vazhdueshëm në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari" në Vrellë ku kemi organizuar aksion në bashkëpunim me Policin kufitare të Aeroportit në lidhje me disa auto-taksi të cilët po tentojnë të ushtrorjnë veprimtari ilegale, pra për ata të cilët i kemi hasur duke ushtruar veprimtari ilegale janë marr masat ndëshkimore në bazë të Ligjit. Po ashtu është bërë inspektimi në rrugën "Lidhja e Prizrenit" ku janë inspektuar auto-taksit të cilët janë të vendosur në këtë rrugë.

Po ashtu gjatë këtij muaji janë inspektuar- kontrolluar edhe kompanitë e autobusëve të cilat operojnë në Komunën e Lipjanit në lidhje me rendin e udhëtimit se ajanë duke e respektuar dhe është bërë kontrollimi për License.

Gjatë këtij muaji janë inspektuar tokat bujqësore ku i'u është ndërruar destinimi, ku nuk i'u është bërë shëndrrimi dhe tokat ku janë mbushur me Dhe nga kompanitë e ndryshme.

Kemi pasur disa aksione mbi dëmtimin e tokave bujqësore në mënyrë të pakontrolluar nga mbushjet me materiale të ndryshme, kemi ndërpre disa vend punime ku bëhej mbushja me material të ndryshëm të cilat nuk posedonin dokumente adekuate nga organi kompetent.

Kemi kontrolluar disa Barnatore Bujqësore mbi afatshmërin e Pesticideve si dhe posedimin e licencave adekuate mbi tregtimin dhe shitjen e Plehut dhe Farës sipas Ligjit për veprimtarin përkatëse.

Gjatë muajit Nëntor në sektorin e ndërtimit janë kontrollu disa objekte afariste, banesore, shtëpi individuale dhe një objekt shkollorë.

Në këtë muaj kanë tentu të ndërtohen dy objekte afariste nga konstruksioni i hekurt në Zk. Konjuhit, mirëpo pas verifikimit dhe kontrolles se këtyre objekteve kanë dal se këto objekte kanë tentu te ndërtojnë pa Leje ndërtimi, atëherë janë marr masa të rrepta në raport me këto objekte ku menjëherë janë blloku me shirita zyrtare dhe janë duke u përcjell se mos po punohet në këto objekte pa Leje Ndërtimi.

Ne rrugën "Isa Olluri" ka filluar të ndërtohet një aneks objekt afarist pa leje ndërtimi, ku të njëjtit i janë vendos shiritat zyrtar, dhe është duke u përcjell se mos po punohet pa lejen e ndërtimit.

Janë kontrolluar disa shtëpi individuale te cilat janë pais me leje ndërtimi.

Është duke u kontrolluar çdo pozicion i punës te të gjitha objektet shumëkatëshe, duke mos i lejuar që ta hedhin betonin ne vepër para se te kontrollohet plani i armaturës nga ana e Inspektoreve te ndërtimit.

Edhe pse disa individ të pa ndërgjegjësohem kanë tentuar ta thejn vendosmërinë e inspektoreve te ndërtimit duke u mundur të ndërtojnë pa leje një gjë të tillë nuk kanë mundur ta arrin ngase kanë hasë në inspektorë të vendosur që ta zbatojnë ligjin, prandaj i kemi ndaluar në forma të ndryshme. Ndaj tyre janë vazhduar mast ndëshkimore gjerë në Gjykatë.